1000/23
09.08.2023

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

RREGULLORE

PËR AMANDAMENTIMIN E RREGULLORES Nr. 01/2020 PËR PUNËN E ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT

Gusht 09, 2023

Bazuar në nenin 98 (Organi Shqyrtues i Prokurimit), nenin 99 (Funksionet dhe Kompetencat e OSHP) lidhur me nenin 106 (Themelimi dhe përbërja e paneleve shqyrtuese) dhe nenin 107 (Rregullorja e procedurave të OSHP) të Ligjit Nr. 04/L-042, Për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-237, me Ligjin Nr. 05/ L-068 dhe Ligjin Nr. 05/ L-092, lidhur me nenin 00, Të Rregullores Nr. 01/2020, Për Punën e Organit Shqyrtues të Prokurimit, Bordi i Organit Shqyrtues të Prokurimit pas procesverbalit te datës 05.06.2023 me 05 qershor 2023, aprovon:

RREGULLORE

PËR AMANDAMENTIMIN E RREGULLORES Nr.01/2020 PËR PUNËN E ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT

Neni 1.
Qëllimi/Amandamentimi

Amandamentohet Rregullorja Nr. 01/2020 e Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, e miratuar me 26 shkurt 2020, ashtu që amandamentimi përfshinë ndryshimet dhe plotësimet e dispozitave të neneve 21 dhe 32, të cilat precizohen në dispozitat vijuese të kësaj Rregulloreje.

Neni 2.
Ndryshimi i nenit 21. Përbërja e Paneleve Shqyrtuese

2.1. Fshihen në tërësi paragrafët 4 dhe 5 të nenit 21, të Rregullores Nr. 01/2020 Për Punën e Organit Shqyrtues të Prokurimit, kurse zbatohen në tërësi paragrafët 2.2. dhe 2.3. të kësaj Rregulloreje.

2.2. Kryetari/ja i/e Organi Shqyrtues të Prokurimit, emëron Panelin Shqyrtues në përbërje individuale (një anëtar) në të gjitha rastet kur ankesa ushtrohet ndaj një akti dhe/ose veprimi të autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit, vlera e parashikuar e të cilit nuk e tejkalon shumën 300.000,00 € (tre/qind/mijë/euro).

2.3. Kryetari/ja i/e Organi Shqyrtues të Prokurimit, emëron Panelin Shqyrtues në përbërje kolegjiale prej 3/tre anëtarëve në të gjitha ato raste:

a) Kur ankesa ushtrohet mbi bazën e diskriminimit, kundër kritereve të shpallur nga ana e autoritetit kontraktues në Dosjen e Tenderit dhe/ose në Njoftimin për Kontratë, lidhur me një aktivitet të prokurimit mund të emëron Panelin Shqyrtues në përbërje kolegjiale prej 3/tre anëtarëve;

b) Kur ankesa ushtrohet ndaj një akti dhe/ose veprimi të një autoriteti kontraktues, për aktivitetin e prokurimit vlera e parashikuar e të cilit e tejkalon shumën 300.000,00 € (tre/qind/mijë/euro), por nuk e tejkalon vlerën e parashikuar në shumën mbi 1,000.000,00 € (një/milion/ euro)

Neni 3.
Plotësimi i nenit 21. Përbërja e Paneleve Shqyrtuese

3.1. Plotësohet neni 4, i Rregullores Nr. 01/2020 Për Punën e Organit Shqyrtues të Prokurimit, me paragrafin vijues të po kësaj dispozite.

3.2. Kryetari i Panelit Shqyrtues në përbërjet kolegjiale (nga 3/tre dhe 5/pesë anëtar), ushtron kompetencat e plota lidhur me mbikëqyrjen, kontrollin dhe ndërmarrjen e të gjitha veprimeve për administrimin e lëndës, nga momenti i caktimit të tij/sajë në cilësinë e Kryetarit të Panelit e deri në vendosjen meritore, përfshirë por pa u kufizuar: veprimet përgatitore, kujdesin mbi caktimin e eksperteve përkatës ne rast te caktimit te serishëm për trajtim, caktimin dhe udhëheqjen e seancës dëgjimore, caktimin dhe udhëheqjen e shqyrtimit kryesor, arsyetimin, dërgimin dhe shpalljen e vendimit.

Neni 5.
Plotësimet dhe ndryshimet

Kjo Rregullore i nënshtrohet ndryshimeve dhe plotësimeve eventuale dhe/ose e njëjta shfuqizohet ose zëvendësohet me Rregulloren përkatëse, vendimin e Bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe në procedurën e ndjetë sikurse të aprovimit të sajë.

Neni 6.
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore, përmban vetitë e aktit normativ nënligjor dhe e njëjta konsiderohet akt me fuqi juridike nga momenti i nënshkrimit nga Kryetari/ja dhe publikimit në faqen zyrtare të Organi Shqyrtues të Prokurimit.

Dispozitat tjera te Rregullorës së Punës së Organit Shqyrtues Nr. 01/20 mbeten te pandryshuara.

Organi Shqyrtues i Prokurimit

Vjosa Gradinaj - Mexhuani, Kryetare